



DOKUMENT I POLITIKAVE LIDHUR ME KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE NGA OSHC-të

2022



Qerkin Berisha

DOKUMENT I POLITIKAVE LIDHUR ME KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE NGA OSHC-të 2022



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD), një projekt i German Marshal Fund of the U.S. (GMF) përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Platforma CIVIKOS. Opinonet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, German Marshal Fund of the U.S., USAID apo Qeverisë së SHBA-së.

PËRMBAJTJA

7	HYRJA
8	2. INFRASTRUKTURA LIGJORE E KONTRAKTIMIT TË SHËRBIMEVE ME OSHC NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
8	2.1. Ligji për Lirinë e Asociimit
8	2.2. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
9	2.3. Ligji për Shëndetësi
10	2.4. Ligji për Ndërmarrjet Sociale
11	2.5. Ligji për Prokurim Publik
11	2.6. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike
12	3. ANALIZA E DISPOZITAVE LIGJORE LIDHUR KONTRAKTIMIT TË SHËRBIMEVE ME OSHC NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
17	4. REKOMANDIMI PËR VEPRIME LIGJORE PËR RREGULLIMIN E KONTRAKTIMIT TË SHËRBIMEVE ME OSHC
18	SHTOJCA 1: KORNIZA E AKTIT NËNLIGJOR PËR KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE ME OSHC

1. HYRJA

Kontraktimi i shërbimeve nga institucionet publike me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) paraqet një formë shumë të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet publike për tek përfituesit e këtyre shërbimeve. Kjo formë është zhvilluar shumë në shtete të Evropës, ndërsa në këto dy dekadat e fundit edhe shtete e ish bllokut lindor kanë zhvilluar infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe kanë filluar të zbatojnë këtë formë të ofrimit të shërbimeve. Kontraktimi i shërbimeve si formë e blerjes/ofrimit të shërbimeve arsyetohet në si në perspektiven e institucioneve publike, ashtu edhe perspektiven e OSHC-ve. Nga perspektiva e institucioneve publike, ofrimi i këtyre shërbimeve trajtohet si një formë e konfliktit të interesit, meqë institucioni i njëjtë harton politika dhe miraton apo propozon legjislacion, dhe zbatimi i saj nga po ashtu i njëjti institucion trajtohet si konflikt i interesit. Po ashtu, mungesa e kapaciteteve humane dhe institucionale bën që këto shërbime të realizohen me më shumë kualitet nëpërmjet kontraktimit. Në anën tjetër, shikuar nga perspektiva e OSHC-ve, këto organizata janë më të specializuara në zgjidhjen e problemeve në lidhje me shërbimet, kanë zgjidhje inovative, janë më fleksibile në rekrutimin e stafit të nevojshme si dhe janë të aftë për të tërhequr edhe fonde të tjera në ofrimin e shërbimit¹, e që kjo ndikon në kontaktimin e shërbimit me një çmim më të ulët sesa kontraktimet që zhvillohen në procedurat e rregullta të prokurimit publik.

Në anën tjetër, edhe në Republikën e Kosovës në vitet e fundit janë zhvilluar me dhjetëra projekte të përafërta ku institucionet publike, në një formë, kanë bërë kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të. Por në mungesë të një akti ligjor dhe procedure të qartë, janë shfrytëzuar procedura të ndryshme të kontraktimit, kryesisht nëpërmjet kontraktimit sipas Rregullore MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (Rregullore Nr. 04/2017) apo akteve të institucioneve me procedura të ngjashme, përjashtimisht edhe me kontraktimin e drejtpërdrejtë. Në këtë dokument të politikave lidhur me kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-së, është bërë identifikimi dhe analiza e infrastrukturës aktuale ligjore në Republikën e Kosovë që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndërlidhen me kontraktimin e shërbimeve në mes të institucioneve publike dhe OJQ-ve. Më pastaj, janë dhënë rekomandimet konkrete lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me hartimin e një akti ligjor lidhur me kontraktimin e shërbimeve. Në fund, është dhënë edhe një kornizë të detajuar për përmbajtjen e aktit nënligjor.

1 Inclusion of Civil Society Organizations in Contracting of Government Tasks, faqe 17 - 18

2. INFRASTRUKTURA LIGJORE E KONTRAKTIMIT TË SHËRBIMEVE ME OSHC NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Që nga themelimi i institucioneve të para në Kosovë, e sidomos pas shpallje së pavarësisë së Republikës së Kosovës, Kosova ka pasur një hov të madh në hartimin legjislativ. Kjo ishte e domosdoshme për të mbuluar boshllëkun legjislativ të një shteti të ri. Por, në kontekst të kontraktimit të shërbimeve me OSHC-të, institucionet publike nuk është hartuar ndonjë akt ligjor të veçantë apo ndonjë dispozitë në kuadër të ndonjë akti tjetër ligjor që rregullon kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të. Në anën tjetër, janë aprovuar dispozita ligjore që kanë rregullim jo të plotë dhe të drejtpërdrejtë, apo kanë rregullim të pjesshëm lidhur me kontaktimin e shërbimeve nga OSHC-të, siç janë Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (Ligji për Lirinë e Asociimit) Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-081 (Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare), Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-043 (Ligji për Shëndetësi), Ligji Nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale (Ligji për Ndërmarrjet Sociale), Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-098 (Ligji i Prokurimit Publik), dhe Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (2008) i plotësuar dhe ndryshuar disa herë me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007 (Ligji për Menaxhimin e Financave Publike).

2.1. Ligji për Lirinë e Asociimit

Ligji për Lirinë e Asociimit në organizata joqeveritare përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, pezullimin, shuarjen, ndalimin e veprimit dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës. Ky Ligj i miratuar në vitin 2019 ka krijuar bazë të qartë ligjore për aktivitetin ekonomik të OSHC-ve, ku sipas dispozitave të këtij Ligji OJQ-të mund të angazhohen në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të tyre jofitimprurëse në përputhje me parimin për "jo përfitim", me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike shfrytëzohen ekskluzivisht për të përmbushur misionin e saj. Po ashtu, OJQ-të mund të kenë dhe të menaxhojnë pronë dhe pasuri për të realizuar qëllimet e veta jofitimprurëse². Sa u përket aktiviteteve ekonomike, OJQ-të, në radhë të parë do të mund të ushtronin aktivitete ekonomike të ndërlidhura me fushën e aktiviteteve të tyre të regjistruara. Aktivitetet ekonomike të OJQ-ve, do të mund të ushtroheshin drejtpërdrejtë nga subjektet juridike të regjistruara si OJQ, apo edhe në ndërlidhje me ligje tjera specifike, siç legjislati për ndërmarrësi sociale që u mundëson OJQ-ve të fitojnë statusin e ndërmarrjes sociale.

2.2. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve

² Ligji për Lirinë e Asociimit, neni 35, paragrafi 2 dhe 3. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>

sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji përbëjnë bazën kryesore për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Republikën e Kosovës. Në çështjen e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, ky ligj ka përcaktuar rol të dyfishtë për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (tashmë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve): rolin e autoritetit qeverisës dhe rolin e ofruesit të shërbimeve. Pra kjo ministri, në njërin anë, harton politika për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe, në anën tjetër, përcaktohet edhe si ofrues i këtyre shërbimeve.³

Megjithatë, ky ligj njeh edhe të drejtën e OSHC-ve për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë ligj. Sipas dispozitave të këtij ligji, organizatat jo qeveritare të regjistruara dhe të licencuara janë të inkurajuar të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, qoftë me nismën e tyre apo me kontratë, dhe për këtë qëllim institucionet publike ofrojnë këshillim dhe udhëzime për këto organizata. Këto organizatat duhet të jenë të regjistruar dhe licencuar. Për më tepër, këto dispozita i mundësojnë Ministrisë dhe komunave të kontraktojnë këto shërbime, ku Komunitat mund të hyjnë në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e saj; dhe Ministria mund të lidh kontrata me organizatat e joqeveritare për ofrimin e shërbimeve specifike sociale dhe familjare në nivel të Kosovës, dhe mund të japë fonde dhe të ofrojë çfarëdo ndihme tjetër materiale, duke përfshirë lokalet, ose këshillat për organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare në nivel të Kosovës⁴.

Krahas këtij ligji janë nxjerrë një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore në zbatim të tij, e në veçanti duhet specifikuar Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare⁵, akt nënligjor i cili ka përcaktuar se OJQ-të dhe subjektet tjera që ofrojnë shërbime sociale duhet të kalojnë nëpër një proces licencimi, që garanton përmbushjen e kriterëve minimale për ofrimin e shërbimeve sociale. Krahas kësaj, ky akt nënligjor, ka mundësuar që jo vetëm OJQ-të, por edhe subjektet tjera të organizuara në formë të personave juridik të mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare pasi të jenë licencuar paraprakisht. Por ky Udhëzim Administrativ nuk rregullon çështje të kontraktimit të shërbimeve, por thjesht fokusohet në procesin e licencimit.

2.3. Ligji për Shëndetësi

Ligji për Shëndetësi ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor. Sipas dispozitave të këtij ligji, “**institucionin shëndetësor**” mund të themelojë çdo person juridik që ofron shërbime të kujdesit shëndetësor, në bazë të licencës së lëshuar⁶. Sipas kësaj dispozite, vërehet që edhe OSHC-të mund të themelojnë institucione shëndetësore, por me aktin nënligjor për zbatimin e kësaj dispozite ligjore

3 Neni 2, paragrafi 1 dhe 2 i Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

4 Neni 8, paragrafi 4,5 dhe 6 i Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

5 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36039>

6 Neni 3, paragrafi 1.19 i Ligjit për Shëndetësi. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

vërehet që fokusi këtu është në licencimin e personave fizik dhe shoqërive tregtare⁷. Megjithatë, ky ligj njih edhe “institucionet shëndetësore humanitare” që themelohet nga organizata joqeveritare dhe jofitimprurëse me seli në Republikën e Kosovës dhe që duhet të kenë licencë për veprimtari shëndetësore⁸. Bazuar edhe në nenin 38 të këtij ligji, ku përcaktohet baza ligjore e rregullimit me akt nënligjore të shërbimet e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore humanitare dhe format tjera të organizimit të shoqërisë civile në lëminë e shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (MSH) Nr. 04/2014 për Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor në Institucionet Shëndetësore Humanitare dhe Format tjera të Organizimit të Shoqërisë Civile në Lëminë e Shëndetësore.⁹ Sipas dispozitave të këtij akti nënligjor, shërbimet shëndetësore që ofrohen në kuadër të projekteve të zbatuara nga shoqëria civile, organizohen në pajtim me ligjin për shëndetësi dhe marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të organizatës jo qeveritare, Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrisë përkatëse të linjës që mbulon subjektin ku do të zbatohet projekti, përfshirë edhe vet subjektin përfitues të shërbimeve.¹⁰ Po ashtu, ky akt nënligjor përcakton që ofrimi i shërbimeve shëndetësore falas nga këto institucione përjashton pagesën e taksës administrative gjatë licencimit të institucioneve shëndetësore humanitare.¹¹

2.4. Ligji për Ndërmarrjet Sociale

Ligji për Ndërmarrjet Sociale rregullon organizimin, funksionimin, parimet, mënyrën e fitimit dhe humbjes së statusit të ndërmarrjes sociale, si dhe përcakton kushtet e kriteret që një subjekt duhet t'i plotësojë që të fitojë statusin e ndërmarrjes sociale. Statusin e ndërmarrjes sociale e përfiton çdo person juridik që përmbush kriteret ligjore, pa marrë parasysh mënyrën e themelimit, përfshirë këtu edhe OSHC-të. Po ashtu, ky Ligj përcakton që ndërmarrjet sociale të tipit A zhvillojnë kryesisht aktivitetet në fushat e ndërlidhura me shërbimet sociale dhe familjare¹².

Lidhur me çështjen e financimit dhe sigurimit të fondeve për funksionin e ndërmarrjeve sociale, ky ligj ka përcaktuar mundësinë e financimit/subvencionimit të ndërmarrjeve sociale si dhe mundësinë e kontaktimit të shërbimeve që ofrojnë këto nëpërmjet përmes procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, ky ligj ka paraparë ndarjen e fondeve për zhvillimin dhe promovimin e ndërmarrjeve sociale nga burimet e ndryshme, ku ministria dhe komunat mund të planifikojnë mjete financiare për mbështetjen e masave të caktuara, përfshirë këtu edhe punësimin e grupeve të cenueshme. Po ashtu ky ligj ka paraparë mundësinë e institucioneve publike, në cilësinë e autoritetit kontraktues, të lidhin kontrata me ndërmarrjet sociale, përmes procedurave të prokurimit, duke respektuar parimet e përgjithshme të transparencës, konkurrencës dhe kontrollit në bazë të legjislacionit në fuqi¹³.

7 Neni 8, paragrafi 2.5 dhe 3.5. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2014 – Procedurat për Licencimin e Institucioneve Private Shëndetësore.

8 Neni 3, paragrafi 1.19 i Ligjit për Shëndetësi

9 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9926>.

10 Neni 4, paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ (MSH) Nr. 04/2014 për Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor në Institucionet Shëndetësore Humanitare dhe Format tjera të Organizimit të Shoqërisë Civile në Lëminë e Shëndetësore. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9926>

11 Po aty, neni 5, paragrafi 3.

12 Neni 5, paragrafi 2, i Ligjit për Ndërmarrjet Sociale.

13 Neni 24 25, dhe 26, i Ligji për Ndërmarrjet Sociale.

2.5. Ligji për Prokurim Publik

Me dispozitat e Ligjit për Prokurimit Publik rregullohen kriteret dhe procedurat e shpenzimit të parasë publike nëpërmjet procedurave të prokurimit. Në ndryshimet e bëra në vitin 2016 në këtë ligj është krijuar korniza ligjore e kontraktimit të shërbimeve me OSHC-të, konkretisht i është mundësuar OSHC-ve që të marrin pjesë në procedurat e prokurimit. Këto ndryshime fillimisht OSHC-të kanë trajtuar si operator ekonomik¹⁴ dhe më pas është krijuar baza ligjore e rregullimit të mëtejshëm të kontraktimit të shërbimeve nga OSHC-të, si në vijim “Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile”¹⁵. Këto dispozita, krijojnë një bazë të qartë ligjore që mundëson një trajtim ndryshe të kontraktimit të shërbimeve publike me Organizatat e Shoqërisë Civile në procedura të prokurimit, kundrejt procedurave standarde të prokurimit në të cilat mund të kontraktohen çdo subjekt juridik.

2.6. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike parqet legjislacionin bazë në fushën e menaxhimit të financave publike në Republikën e Kosovës, dhe rrjedhimisht pothuajse çdo institucion publik në Republikën e Kosovës është i detyruar të bazohet në dispozitat e tij, me rastin e shpenzimit të parasë publike. Në lidhje me shpenzimin e parasë publike në formë të subvencioneve, e që kjo ndërlidhet me financimin publik të OSHC-ve, neni 53 i këtij Ligji parasheh që Ministri përkatës për financa është shprehimisht i autorizuar që të nxjerrë rregullat të cilat duhet të respektohen nga organizatat buxhetore ose autoritetet publike gjatë përzgjedhjes së pranuesit ose pranuesve si dhe përcaktimit të shumës ose shumave të cilat do të open në formë të grantit, donacionit ose subvencionit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që procesi të ketë për qëllim arritjen e synimeve të Kuvendit kur i njëjti e ka autorizuar grantin, donacionin ose subvencionin përkatës në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore.¹⁶ Këto dispozita ligjore krijojnë bazën ligjore për rregullimin e kriterëve dhe procedurave të shpenzimit të parasë publike nga kategoria e “Subvencionet dhe Transferet”. Megjithëse këto dispozita janë të natyrë së përgjithshme, ato krijojnë një bazë të qartë për ofrim të subvencioneve, granteve dhe donacioneve pa përjashtim si për OSHC-të, bizneset dhe individët, kur një financim i tillë është planifikuar në ndarjet buxhetore vjetore.

Në kontekstin e këtyre dispozitave në vitin 2017 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka nxjerrë Rregullore MF-Nr. 04/2017, e cila rregullon në mënyrë unike financimin publik të OJQ-ve për të gjitha organizatat buxhetore. Kjo Rregullore përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të OJQ-ve, me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik të në Republikën e Kosovës. **Në anën tjetër, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve** nuk ka nxjerrë akoma ndonjë akt nënligjor të ngjashëm me Rregulloren 04/2017, për të rregulluar financimin e entiteteve tjera nga OJQ (individ, shoqëri tregtare apo trupa tjerë), e cila do të kishte po ashtu të njëjtën bazë ligjore nenin 53 të Ligjit të Menaxhimit të Financave Publik, e cila do të mund të rregullonte më tej këtë proces.

14 Neni 4 (1.19) Ligji për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>

15 Neni 132 A i Ligjit për Prokurimin Publik. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

16 Neni 53, Par. 3, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Versioni Elektronik i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

3. ANALIZA E DISPOZITAVE LIGJORE LIDHUR KONTRAKTIMIT TË SHËRBIMEVE ME OSHC NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Dispozitat ligjore të prezantuara në pjesën e dytë të këtij dokumenti të politikave dëshmojnë për ekzistimin e një baze ligjore solide për kontraktimin e shërbimeve me OSHC, por edhe të kriterëve dhe procedurave për lidhjen e marrëveshjeve të kontraktimit.

Vlerësuar nga e drejta e OSHC-ve për të kontraktuar shërbime me institucionet publike, vërehet qartë që infrastruktura ligjore primare është pothuajse e kompletuar:

- Fillimisht, nëpërmjet Ligjit për Lirinë e Asociimit është normuar e drejta e OSHC-ve për ushtrimin e aktivitetet ekonomik për qëllime jo të përfitimit dhe e drejta për menaxhuar pronë dhe pasuri, bazuar po në të njëjtin qëllim. Bazuar në këto dispozita, të gjitha OSHC-të mund të ushtrojnë aktivitet ekonomik pas plotësimit të kushteve ligjore për ushtrimin këtij aktiviteti ekonomik, përveç nëse një lloj i veprimtarisë ekonomike është e ndaluar të ushtrohet nga kjo kategori në mënyrë eksplicite;
- Më pastaj, nëpërmjet Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligjit për Shëndetësinë, është rregulluar e drejta e OSHC-ve për të ofruar shërbime sociale dhe familjare, dhe shërbime shëndetësore. Dispozitat e Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare janë ndër dispozitat më të favorshme dhe të qarta sa i përket kontraktimit të shërbimeve sociale dhe familjare me OSHC-të, ku këto dispozita krijojnë bazë ligjore për kontraktim të këtyre shërbimeve në rastet kur organet shtetërore që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të tilla dhe nuk i ofrojnë shërbimet e tilla. Ngjashëm me këtë, edhe dispozitat e Ligji për Shëndetësinë janë shumë të favorshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ku kjo formë paraqitet si mundësinë suplementare, krahas formave tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Për më tepër, ofrimi i këtyre shërbimeve shëndetësore pa pagesë incentivizohet me mos pagesën e taksës administrative për licencimin e institucioneve humanitare. Vlen të theksohet se ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, dhe i atyre shëndetësore është i kushtëzuar me regjistrimin dhe licencimin e OSHC-ve nga Ministritë e linjës. Por, institucionet publike nuk kanë hartuar akte normative apo akte të ngjashme që përcaktojnë procedurat për kontraktimin e këtyre shërbimeve nga OSHC-të;
- Në anën tjetër, Ligi për Ndërmarrjet Sociale ka përcaktuar që çdo subjekt që e fiton statusin e ndërmarrjes sociale ka të drejtë të fitojë grante për promovimin e ndërmarrjeve sociale dhe të kontraktohet për ofrimin e shërbimeve. OJQ-të me status të ndërmarrjes sociale do të mund të përfitonin edhe nga legjislacioni tatimor. Ky ligj ka përcaktuar që kontraktimi i shërbimeve të bëhet nëpërmjet procedurave të prokurimit, ndërsa përfitimi nga këto grantet supozohet të bëhet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloren Nr. 04/2017, nën supozimin se ndërmarrja sociale është regjistruar si OJQ.

Vlerësuar nga diskrecioni i institucioneve publike për të kontraktuar shërbime nga OSHC-të, vërehet se ka bazë të mirëfilltë ligjore por ka mungesë të theksuar të procedurave ligjore që duhet të ndiqen:

- Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji për Shëndetësinë, edhe pse kanë normuar dhe avancuar kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të, ato nuk kanë specifikuar procedurat dhe kriteret e kontraktimit të këtyre shërbimeve. Ligji për

Shërbimet Sociale dhe Familjare si formë parasheh “**procedurat e komisionimit dhe kontraktimit**”, ndërsa Udhëzimi Administrativ (MSH) Nr. 04/2014 për Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor në Institucionet Shëndetësore Humanitare dhe Format tjera të Organizimit të Shoqërisë Civile në Lëminë e Shëndetësore si formë parash “**marrëveshjen e bashkëpunimit**”. Sidoqoftë, dispozitat e mësipërme ligjore, nuk përcaktojnë procedurat e kontraktimit të shërbimeve sociale dhe familjare, port vetëm krijojnë bazën për lejimin e kontraktimit të tillë. Përjashtimisht, Ligji për Ndërmarrësin Sociale ka paraparë procedurat e prokurimit publik për kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të;

- Ligji i Prokurimit Publik i ka dhënë statusin e operatorit ekonomik edhe OSHC-ve dhe ka krijuar bazën ligjore për hartimin e një akti nënligjor të procedurave dhe kriterëve për kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të. Edhe pse kjo dispozitë lë shumë hapësirë për rregullim të procedurave prokuruese për OSHC-të që kanë të bëjnë me kontraktimin e shërbimeve, deri më tani një dispozitë e tillë nuk shfrytëzuar për të nxjerrë aktin nënligjor për të rregulluar procedura specifike vetëm për kontraktimin e shërbimeve për OSHC-të. Si rrjedhojë, kjo e bën të pamundur kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të.
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike ka dhënë kompetenca Ministrit përkatës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e granteve. Megjithatë, baza ligjore në këtë rast i referohet shpenzimit të parasë publike (granteve) nga kategoria ekonomike “Subvencione dhe Transfere”, që dallon shumë nga kontraktimi i shërbimeve. Bazuar në këtë dispozitë është nxjerrë Rregullorja Nr. 04/2017. Nga këndvështrimi i legjislacionit për menaxhimin e financave publike, edhe pse nuk përmendet shprehimisht ofrimi i shërbimeve/ kontraktimi i shërbimeve, një numër i konsiderueshëm i projekteve që financohen duke u bazuar në këtë rregullore kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve sociale apo shëndetësore për kategori të caktuara të shoqërisë, për të cilat ekzistojnë obligime në anën e institucioneve shtetërore. Rrjedhimisht, rregullorja e lartcekur shërben indirekt edhe në rastin e kontraktimit të shërbimeve nga OJQ-të. Këtu duhet bërë një dallim i qartë në mes të shërbimeve që ofrohen në të mirë të publikut, për të cilat institucionet kanë detyra dhe përgjegjësi, dhe blerjes së shërbimeve nga ana e institucioneve për plotësimin e nevojave të tyre. Megjithatë, rregullorja nuk ka specifikuar dhe rregulluar situatat e kontraktimit të shërbimeve, gjë që do të mund të rregullohej me plotësim ndryshimin e saj.

Andaj, si konkluzion mund të konstatohet që baza ligjore e realizimit të drejtës së OSHC-ve për kontraktimin e shërbimeve është e plotë, por për nevojat e institucioneve publike mungon një akt normativ që përcakton kriteret dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve. Kësisoj, situata aktuale bën që institucionet publike të procedojnë sipas Rregullores Nr.04/2017, sipas procedurave të ngjashme të nxjerra nga vetë autoritetet apo edhe nëpërmjet kontraktimit të drejtpërdrejtë.

Me qëllim të modelimit së zgjidhjes dhe me qëllim të qartësimit nëse rregullimi i kriterëve dhe procedurave të kontraktimit të shërbimeve me OSHC duhet rregullohet me një akt nënligjore që rrjedh nga Ligji i Prokurimit Publik apo duhet të zgjedhur ndonjë modalitet tjetër, duhen analizuar konceptin e kontraktimit të shërbimeve si dhe kategorinë ekonomike nga e cila financohet kontraktimi.

Procesi i buxhetimit në Republikën e Kosovës realizohet në pesë kategori ekonomike të shpenzimeve, përfshirë këtu kategorinë “Mallra dhe Shërbime” dhe kategorinë “Subvencione dhe Transfere”. Specifikimi i më hollësishëm i këtyre kategorive ekonomike të shpenzimeve

është bërë nga “Rregulli Financiar 01/2013/MF Shpenzimi i Parasë Publike”. Sipas kësaj Rregulle, shpenzimi i parasë publike nga kategoria “Subvencionet dhe Transferet” nuk kërkon që të zhvillohet një procedurë e prokurimit publik¹⁷. Po ashtu, pagesat që realizohen nga kjo kategori janë pagesa të njëanshme dhe jo të kthyeshme, në përputhje me një bazë të qartë juridike (ligj, rregullore ose vendim), që i mundëson organizatës të bëjë një pagesë të tillë nga kjo kategori. Pagesa e pakthyeshme, sipas kësaj Rregulle, kanë natyrë të tilla dhe janë të njëanshme, meqë në këtë rast nuk ka mallra apo shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesën. Në anën tjetër, për kategorinë e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime” në përgjithësi, ky Rregull nuk parash përjashtimin e rregullave të prokurimit publik, përveç në disa raste.

Andaj, bazuar në këto dispozita, mund të konkludohet se shpenzimi i parasë publike nga kategoria e “Subvencione dhe Transfere” duhet të bëhet me qëllim të subvencionit të projekteve/programave të OSHC-ve (meqë në këtë rast nuk ka blerje të mallrave apo shërbimeve), ndërsa shpenzimi i parasë publike nga kategoria ekonomike e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime” duhet të bëhet me qëllim të kontraktimit të shërbimeve nga OSHC-të (meqë në këtë rast kemi blerje të shërbimeve). Pra, bazë për ndarjen ose rregullimin ndaras të financimit të programit dhe projekteve të OSHC-ve nga kontraktimi i shërbimeve me OSHC-të, nga perspektiva e organizatave buxhetore është kategoria ekonomike se ku janë të buxhetuar mjetet në ndarjet buxhetore.

Në anën tjetër, koncepti i kontraktimit të shërbimeve lidhet ngushtë me përgjegjësitë e institucioneve publike. Praktikato ndryshme të shteteve tjera dëshmojnë që bëhet kontraktimi i atyre shërbimeve që institucionet publike ligjërisht (me kushtetutë, ligj apo akt nënligjor) duhet të ofrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe kontraktimi i të cilëve nuk është i ndaluar me legjislacionin në fuqi¹⁸, siç është shembulli i sigurimit të shkollimit pa pagesë deri në një moshë të caktuar. Ky obligim për shumë shtete buron nga instrumentet ndërkombëtare dhe nga dispozitat kushtetuese dhe paraqet një obligim ligjor për autoritet publike që duhet të ofrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në pamundësi, këto shërbime duhet të kontraktohen nga autoritetet publike. Lidhur me këtë çështje, rregullimi ligjor është i ngjashëm edhe në Republikën e Kosovës, ku Kushtetuat garanton ofrimin pa pagesë të shkollimit themelorë. Në anën tjetër, ndër arsyet kryesore të kontraktimit të këtyre shërbimeve janë kapaciteti i kufizuar i institucioneve publike, nevoja që puna e tyre të fokusohet në fushën e hartimit të politikave në fushat tjera themelore, arritja më e lehtë e objektivit të institucionet, vlera e shtuar e partnerëve realizues dhe llogaridhënia më e mirë në harxhimin e parasë publike.¹⁹

Si rrjedhojë, kontraktimi i shërbimeve nga institucionet shtetërore duhet të zhvillohet për shërbimet që institucioni ka detyrim ligjor të ofrojë, për të cilin mund të ketë edhe resurse humane dhe financiare, por për arsye të ndryshme (ekonomizimi i shpenzimeve, siguri i shërbimit më të mirë, evitimi i konfliktit të interesit, efikasiteti i shërbimeve dhe arsye të ngjashme) vendos të bëjë kontraktimin e shërbimeve. Ky kontraktim zhvillohet me mjetet e institucionit publik të cilat janë të buxhetuara në kategorinë e shpenzimeve ekonomike “Mallra dhe Shërbime”. Në anën tjetër, financimi publik i OSHC-ve bëhet për përmbushjen e një objektivit/aktiviteti programor (jo obligim ligjor) dhe për të cilin aktiviteti institucioni publik nuk ka dhe nuk supozohet të ketë staf administrativ. Ky financim zhvillohet me mjetet e institucionit publik të cilat janë të buxhetuara në kategorinë e shpenzimeve ekonomike “Subvencione dhe Transfere”.

Lidhur me këtë konstatim, mund të marrim shembuj si në vijim:

¹⁷ Neni 21, Rregull financiare NR.01/2013/MF – shpenzimi i parave publike.

¹⁸ Shih Inclusion of Civil Society Organizations in Contracting of Government Tasks, faqe 2 - 4

¹⁹ Shih A Handbook on Non State Social Service Delivery Models, faqe 23 -26

- Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare jep një shembull konkret të kontraktimit të shërbimeve. Sipas këtij ligji në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t'u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale²⁰. Pra këto dispozita i përcaktojnë institucioneve shtetërore, përkatësisht Ministrisë përkatëse për mirëqenie sociale dhe Komunave të Republikës së Kosovës obligimin për t'i siguruar individit shërbime sociale dhe familjare, për të siguruar dinjitetin e tij. Në këto raste, institucionet publike obligohen që fillimisht të mundohen të bëjnë zgjidhjen nëpërmjet kontraktimit të shërbimeve (në suaza të komunitetit), nëpërmjet sistemimit të tyre nëpërmjet familjeve tjera. Në raste të jashtëzakonshme, këto institucione do të kenë diskrecionin të vendosin nëse do të ofrojnë këto shërbime me resurset e brendshme (nëse kanë në menaxhim institucione rezidenciale) apo të kontraktojnë këto shërbime, nëpërmjet institucioneve rezidenciale jo publike.
- Një shembull të ngjashëm kemi edhe puna e Organit të Kujdestarisë, funksioni i të cilit është i rregulluar me Ligji Nr. 2004/32 për Familjen dhe me Ligjin për Shërbimet Social edhe Familjare. Sipas Ligjit për Familjen, ky organ ka përgjegjësi të sigurojë se të gjitha të drejtat dhe interesat e personit nën kujdestari janë të garantuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe format tjera të mbrojtjes të siguruara me ligj për të ndihmuar të miturit dhe personat e moshës madhore. Po ashtu, ky organ zbaton masat edukative dhe masat tjera të përcaktuara nga gjykata, si dhe ndërmerr dhe i mbikëqyr të gjitha aktivitetet nën kompetencën e tij.²¹ Edhe në këtë rast kemi një përgjegjësi ligjore për institucionet publike, që mund të sigurohen nëpërmjet resurseve të brendshme (nëse ka të mjaftueshme dhe nëse vlerësohet si metodë e duhur) apo nëpërmjet kontraktimit të shërbimeve.
- Në anën tjetër, një shembull të financimit të projekteve dhe programeve, kemi në një shpallje të publikuar nga Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit. Kjo Ministri njofton se “në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore për vitin 2022 renditë ndër prioritetet programore fuqizimin e rolit të skenës së pavarur kulturore në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, rritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike, identifikimin dhe mbështetjen e talentëve të rinj, aktivizimin e të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete të fushës së artit dhe trashëgimisë kulturore, rrjetëzimin dhe promovimin e produktit vendor kulturor si produkt konkurrues në tregun ndërkombëtar të industrisë kreative”²² Andaj, me qëllim të realizimit të këtyre prioritetëve Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shpallur shpallje publike sipas kriterëve dhe procedurave të Rregullores MF -Nr. 04/2017 për financim të OJQ-ve në këto fusha. Konkretisht, aktiviteti i rritjes së cilësisë së krijimtarisë artistike nuk mund të arrihet nëpërmjet stafit të Ministrisë, Po ashtu, në këtë thirrje Ministria ka renditur edhe objektivat e thirrjes (Promovimi i artit dhe trashëgimisë kulturore përmes pasurimit, diversifikimit dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore, nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën kulturore brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, me theks tek fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, fuqizimi i koordinimit dhe partneritetit

²⁰ Neni 1.2. i Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-081

²¹ Neni 234, Ligji Nr. 2004/32 për Familjen

²² Shih [Thirrja publike Kulture dhe Trashëgimi.pdf \(mkrs-ks.org\)](#),

ndërmjet institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe shoqërisë civile përmes fuqizimit të skenës së pavarur kulturore dhe nxitjes së akterëve të rinj që veprojnë në fushën e kulturës dhe të ngjashme).

Një çështje tjetër që duhet të gjejë epilog është edhe baza ligjore dhe fushëveprimi i aktit normativ që do të rregullonte fushën e kontraktimit të shërbimeve me OSHC-të. Bazuar në analizat e legjislacionit që ndërlidhen me kontraktimin e shërbimeve me OSHC, vërehet janë dy opsione për akte nënligjore: Akti nënligjor që derivon nga Ligji i Prokurimit Publik, ku përcaktohen parimet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve operatorët ekonomik, përfshirë edhe OSHC-të, si opsion i parë; dhe akti nënligjor që derivon nga Ligji i Menaxhimit të Financave Publike, ku njashtu do të përcaktohen parimet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve nga OSHC, si opsion i dytë. Një praktikë të tillë kanë edhe vendet tjera, ku në shumë vende legjislacioni kryesor që rregullon kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të është ai i prokurimit publik. Përrjashtimisht, mund të hasen edhe procedura të tjera në vende të ndryshme.²³

Opsioni i parë paraqitet si opsion i rekomanduar, meqë tashmë ekziston baza ligjore në Ligjin e Prokurimit Publik (si rezultat i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 – 2017) dhe është më e lehtë e realizueshme. Po ashtu, konsiderohet të jetë edhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike, meqë shpenzimi i parasë publike bëhet nga kategoria e shpenzimeve ekonomike “Mallra dhe Shërbime”. Për më tepër, kjo është në linjë edhe me obligimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës për përafrimin e legjislacionit të saj me *Acquis*, mbase në nivel të legjislacionit të BE-së kjo fushë është e rregulluar me Direktivat përkatëse të prokurimit publik.

Opsioni i dytë do të kërkonte krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore në Ligjin e ri të Menaxhimit të Financave Publike (meqë ky Ligj është në proces të plotësimit ndryshimit), dhe pastaj hartimi i një akti nënligjor për kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të.

Ky dokument i politikave rekomandon adoptimin e opsionit të parë, pra hartimit të aktin nënligjor bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, për kontraktimin e shërbimeve me OSHC.

23 Shih *Inclusion of Civil Society Organizations in Contracting of Government Tasks*, faqe 20

4. REKOMANDIMI PËR VEPRIME LIGJORE PËR RREGULLIMIN E KONTRAKTIMIT TË SHËRBIMEVE ME OSHC

Me qëllim të rregullimit të saktë të infrastrukturës ligjore për kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të, duhet koordinim ndërinstitucional dhe veprime të ndryshme ligjore, si në vijim:

- **Ligji i ri i Prokurimit Publik duhet të ruaj trajtimin e OSHC-ve** – Meqë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është duke e përgatitur Projektligjin për Prokurimin Publik, duhet siguruar që trajtimi i garantuar për OSHC-të sipas ligjit aktual të reflektohet edhe në Projektligjin e ri. Kjo është shumë lehtë e argumentueshme, meqë legjislacioni i BE-së ka një rregullim të ngjashëm dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të MSA-së, është e obliguar të bëjë transpozimin e këtij legjislacioni. Kjo dispozitë duhet të krijojë bazën ligjore që me akt nënligjor të evitohen disa procedua dhe afate që mund të jenë të paarsyeshme për këtë lloj të kontraktimit;
- **Rregullorja e re për Financimin Publik të OJQ-ve duhet të kufizojë fushëveprimin e saj vetëm në financimin e projekteve/programeve, dhe të mos vlejë për kontraktimin e shërbimeve** - Meqë edhe ky akt nënligjor është në proces të plotësimit dhe ndryshimit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, duhet të siguruar që ky akt nënligjor vlen vetëm për financimin e OSHC-ve nga kategoria e “Subvencioneve dhe Transfereve”; dhe
- **Duhet të hartohet akti nënligjorë për kontraktimin e shërbimeve, përfshirë këtu edhe shërbimet nga OSHC** – Bazuar në Ligjin e ri të Prokurimit Publik dhe marrë parasysh kriteret e legjislacionit të BE-së dhe përvojat më të mira, nën sponsorizimin e MFPT-së dhe KRPP-së, duhet të hartohet akti nënligjor për kontraktimin e shërbimeve me OSHC, dhe të miratohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

SHTOJCA 1: KORNIZA E AKTIT NËNLIGJOR PËR KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE ME OSHC

Bazuar në një analizë paraprake, akti nënligjor për kontraktimin e shërbimeve me OSHC-mund të ketë 5 kapituj. Përmbajtja e kapitujve do të varet se çfarë rregullimin do të ketë Ligji i ri i Prokurimit Publik. Nën supozimin që rregullimi do të jetë bazik, këto kapitujt duhet të mbulojnë çështjet si në vijim:

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Në këtë kapitull duhet të përcaktohet qartë qëllimi i aktit (kontraktimi i shërbimeve nga operatorët ekonomike, përfshirë edhe OSHC-të), fushëveprimi i saj, legjislacionin e BE-së që transpozon (Direktiva Nr. 24/2014 dhe 25/2014), definicionet dhe parimet e përgjithshme.

Në fushëveprimin e këtij akti nënligjor duhet të specifikohet që nuk ka fushëveprim të kufizuar vetëm për kontraktim të shërbimeve nga OSHC-të, por fushëveprimi i tij është kontraktimi i shërbimeve të caktuara sociale nga gjithë operatorët ekonomik, përfshirë këtu edhe OSHC-të, si dhe kufizimet që shërbime të caktuara mund të kontraktohen vetëm nga OSHC-të.

Po ashtu, në fushëveprim duhet të përcaktohet saktë se për cilat lloje të shërbimeve është e lejuar kjo procedurë dhe cilat lloje të shërbimeve nuk mund të kontraktohen me këtë akt nënligjor. Sipas legjislacionit të BE-së, shërbimet që mund të kontraktohen janë përcaktuar në Shtojcën XVI të Direktivës 24/2014, si në vijim:

1. Shërbime shëndetësore, sociale dhe shërbime të lidhura me to;
2. Shërbime administrative, sociale, arsimore, shëndetësore dhe kulturore;
3. Shërbime të sigurimeve shoqërore të detyrueshme;
4. Shërbime përfitimi;
5. Shërbime të tjera komunitare, sociale dhe personale, duke përfshirë shërbimet e ofruara nga sindikatat, organizatat politike, shoqatat rinore dhe shërbime të tjera për anëtarë të organizatave;
6. Shërbime fetare;
7. Shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve;
8. Shërbime ligjore të caktuara;
9. Shërbime të tjera administrative dhe shërbime shtetërore;
10. Ofrimi i shërbimeve për komunitetin;
11. Shërbime që lidhen me burgun, sigurinë publike dhe shërbime shpëtimi të caktuara,
12. Shërbimet hetimore dhe të sigurisë,
13. Shërbime ndërkombëtare; dhe

14. Shërbimet postare dhe shërbime të tjerat të ndryshme.

Sa i përket parimeve të përgjithshme, në këtë pjesë duhet të reflektohen parimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike, në njërin anë, dhe të kontraktimit të shërbimeve, në anën tjetër. Si dy parime kryesore lidhur me kontraktimin e shërbimeve na paraqiten parimi i transparencës dhe trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomik²⁴, por edhe parimet si konkurrueshmëria, efektiviteti dhe efikasiteti i shpenzimit të parasë publike, kriteret e përcaktuara paraprakisht, dyshkallshëmia dhe ruajtja e pavarësisë së përfituesve duhet të normohen për këtë akt nënligjor.

Në këtë pjesë rekomandohet që të mbahet një definicion më të gjerë për OSHC-të (një definicion përtej organizatës jo qeveritare), përfshirë këtu entitetet e veçanta, bashkësitë fetare dhe organizatat të ngjashme. Kjo, për të krijuar bazën ligjore e kontraktimit të shërbimeve nga këto entitete.

Po ashtu, në kuadër të traspozimit të Direktivave të BE-së, duhet të ketë një periudhë transitore lidhur me minimumin e shumave që do të prokurohen, meqë legjislacioni i BE-së ka përcaktuar që këto kritere dhe procedura janë të vlefshme për shumat e barabarta me apo më të larat se 750 000 €, respektivisht 1 000 000 €, shuma këto që mund të jenë të larta për Republikën e Kosovës. Prandaj, duhet të shihen edhe rregullat e përgjithshme të ligjit të Prokurimit, sa i përket shumave për kontrata të ndryshme.

Prandaj, akti nënligjor, duhet qartë të përcaktoj cilat shërbime mund të rezervohen vetëm për OSHC-të, rrjedhimisht, autoriteti kontraktues do të mund të rezervoj të drejtën vetëm për OSHC-të të marrin pjesë në një procedurë të tillë kontraktimi. Për rastet, kur procedura nuk është e rezervuar për OSHC-të do të duhej të vlejnjë dispozitat e përgjithshme të ligjit të Prokurimit që edhe ashtu lejojnë OJQ-të të aplikojnë për ofrim të shërbimeve krahas çdo subjekti tjetër.

KAPITULLI II – LIDHJA E KONTRATAVE PËR KONTRAKTIM TË SHËRBIMEVE ME OSHC

Në këtë kapitull duhet të normohet të gjitha veprimet nga planifikimi dhe shpallja e tenderit deri tek lidhja e kontratave.

Në këtë kapitull duhet të rregullohet fillimisht procesi i shpalljes së tenderit. Shpallja e tenderit mund të bëhet ndërmjet njoftimit të kontratës dhe nëpërmjet njoftimit paraprak të informacionit.

Njoftimi i kontratës duhet të përmbajë elementet si në vijim:

1. Emrin, numrin e identifikimit (kur parashihet në legjislacionin e brendshëm), adresa, duke përfshirë kodin NUTS, adresa elektronike dhe e internetit të autoritetit kontraktues;
2. Kodin NUTS për vendndodhjen kryesore të punëve, në rastin e punëve ose kodi NUTS për vendin kryesor të lëvrimit ose të zbatimit, në rastin e furnizimeve dhe shërbimeve;
3. Përshkrimi i shkurtër i kontratës në fjalë, duke përfshirë kodet e FPP-së;
4. Kushtet për pjesëmarrje, duke përfshirë:
 - 4.1. sipas rastit, të tregohet nëse kontrata kufizohet në organizatat të punësojnë persona me aftësi të kufizuar ose nëse zbatimi i saj kufizohet në kuadrin e programe të sigurisë

²⁴ Neni 76. Paragrafi 1 i Direktivës 24/2014

në punë;

4.2. sipas rastit, të tregohet nëse kryerja e shërbimeve është e drejtë e reverzuar me ligj, rregullore ose dispozitë administrative në për një profesion të veçantë;

5. Afatet kohore për të kontraktuar autoritetin kontraktues në lidhje me pjesëmarrjen; dhe

6. Përshkrimi i shkurtër i tipareve kryesore të procedurës së prokurimit që do të zbatohet²⁵.

Si alternativë, shpallja mund bëhet edhe nëpërmjet njoftimit paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i informacionit duhet t'i referohet në mënyrë specifike llojeve të shërbimeve që do të jenë objekt i kontratave që do të jepen dhe aty duhet të përcaktohet që kontratat do të jepen pa shpallje të mëtejshme dhe ftohen operatorët ekonomikë të interesuar që të shprehin interesin e tyre me shkrim. Njoftimit paraprak të informacionit duhet të përmbajë informatat si në vijim:

1. Emri, numri i identifikimit (kur parashihet në legjislacionin në fuqi), adresa duke përfshirë kodin NUTS, adresa elektronike dhe e internetit e autoritetit kontraktues; dhe

2. Përshkrimi i shkurtër i kontratës në fjalë duke përfshirë vlerën totale të parashikuar të kontratës dhe kodet e FPP-së²⁶

Në shpallje mund të shtohen edhe elemente të tjera siç janë kushtet e aplikimit dhe kërkesat nga aplikantët, karakteristikat specifike të shërbimit të kontraktuar, buxheti, dokumentacioni përkatës i nevojshëm për aplikim, mënyra e aplikimit dhe data e mbylljes, metodologjia e vlerësimit si dhe specifikat tjera të nevojshme.

Po ashtu, në këtë kapitull duhet të përcaktohet që kontraktimi i këtyre shërbimeve mund të bëhet edhe nëpërmjet negocimit të drejtpërdrejtë (pa procedurë konkurruese) në përputhje me kriteret e përcaktuar në Ligjin e Prokurimit Publik, apo edhe duke specifikuar edhe rrethana shumë specifike (në rast të fatkeqësive natyrore, në rast të kolapsit teknologjik, në raste kur është domosdoshme mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njeriut, në raste kur është qartësisht e dukshme që nuk ka konkurrencë në fushën e shërbimit që synohet të kontraktohet, në rast se qëllimi i shërbimit që synohet të kontraktohet është i komplikuar dhe asnjë autoritet publik nuk mund të ofrojë këtë shërbim).

Sa i përket procedurave të vlerësimit të ofertave, përveç dispozitave të përgjithshme të Ligjit të Prokurimit Publik, këtu mund të bëhen specifikime shtesë në disa fusha siç përcaktimi që kriteri dominues është përvoja paraprake e përgjithshme dhe veçantë, kapacitetet administrative dhe kualifikimi i stafit, qëndrueshmëria financiare të kenë përparësi të dukshme në krahasim me çmimin e ofertës; në përbërje të komisioneve vlerësuese të ketë mundësi të pjesëmarrjes në cilësinë e anëtarit apo të vëzhguesit të ndonjë eksperti të jashtë, dispozita të veçanta që të mos ketë vonesa në kontraktim dhe kriteret të ngjashme.

Po ashtu, në këtë kapitull duhet të specifikohet që një modul i veçantë i e-prokurimit duhet të zhvillohet, për të mundësuar zbatimin e këtij akti nënligjor me specifikat përkatëse.

Akti nënligjor, duhet të bëjë të qartë që në një procedurë të prokurimit mund të kontraktohen më shumë OSHC për të ofruar shërbime. P.sh. shërbimet sociale dhe familjare ofrohen nga një numër më i madh i OJQ-ve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Krahas kësaj, duhet të parashihet edhe mundësia e bashkëpunimit në mes të nivelit

²⁵ Direktiva 24/2014, Shtojca V, Pjesa H

²⁶ Direktiva 24/2014. Shtojca V, Pjesa I

Qendror dhe Lokal, apo ndërmjet më shumë se një organizate buxhetore në kontraktimin e shërbimeve të tilla.

KAPITULLI III – REZERVIMI I KONTRATAVE TË CAKTUARA PËR KONTRAKTIM TË SHËRBIMEVE ME OSHC

Akti nënligjor duhet të autorizojë Qeverinë e Republikës së Kosovë për mundësinë e rezervimit të të drejtës në pjesëmarrje në procedurat për dhënien e kontratave publike ekskluzivisht për shërbime shëndetësore, sociale dhe kulturore për organizatat që i ofrojnë këto shërbime. Këto kontrata do të mund të lidhen me një afat deri në 3 vjet. Lista e plotë e këtyre shërbimeve sipas Direktivës Nr. 24/2014, së bashku me kodet CPV është si në vijim:

1. Shërbimet administrative arsimore (me kod 75121000-0);
2. Shërbimet administrative të kujdesit shëndetësor (me kod 75122000-7);
3. Shërbimet administrative të strehimit (me kod 75123000-4),
4. Shërbime të furnizimit të personelit të brendshëm ndihmës (me kod 79622000-0);
5. Shërbime të furnizimit të personelit të infermierisë (me kod 79624000-4);
6. Shërbime të furnizimit të personelit mjekësor (me kod 79625000-1);
7. shërbime të arsimit parashkollor (me kod 80110000-8);
8. Shërbime të arsimit të lartë (me kod 80300000-7);
9. Shërbime e-mësimi (me kod 80420000-4);
10. Shërbime universitare për të rriturit (me kod 80430000-7);
11. Shërbime të trajnimit të stafit (me kod 80511000-9);
12. Pajisjet e trajnimit (me kod 80520000-5);
13. Shërbime tutoriale (me kod 80590000-6);
14. Të gjitha shërbimet të shëndetit dhe punës sociale (nga kodi 85000000-9 deri në kodin 85323000-9);
15. Shërbime bibliotekare, arkivave, muzeve dhe shërbime të tjera kulturore (me kod 92500000-6);
16. Shërbime sportive (me kod 92600000-7);
17. Shërbime të ofruara nga organizatat me karakter sociale (me kod 98133000-4); dhe
18. Shërbime të ofruara nga shoqata rinore (me kod 98133110-8).

Gjatë procesit të përgatitjes së aktit nënligjor, këto kode duhet të zërthehen, duke përfshirë edhe nën-kodet specifike për secilin lloj të shërbimeve.

Direktiva në fjalë përmban edhe disa kushte specifike sa i përket shërbimeve të rezervuara:

1. qëllimi i saj duhet të jetë është zbatimi i objektivave të shërbimit publik të lidhur me

ofrimin e shërbimeve të rezervuara;

2. fitimet duhet të ri-investohen me synimin për të arritur objektivin e organizatës. Kur fitimet shpërndahen ose rishpërndahen, kjo duhet të bazohet në kontributet përkatëse. Kjo në veçanti, është e aplikueshme për OJQ-të me status të ndërmarrjeve sociale, të cilat sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë nuk kanë të drejtë të shpërndajnë fitim.

3. strukturat e menaxhimit ose të pronësisë së organizatës që përmbush kontratën bazohet në parimet e pronësisë së punonjësve ose parime të ngjashme të pjesëmarrjes, ose kërkojnë pjesëmarrjen aktive të punonjësve, përdoruesve ose palëve të interesuara. Kjo në veçanti, është e aplikueshme për OJQ-të me status të ndërmarrjeve sociale, të cilat duhet të reflektojnë një kërkesë të tillë në dokumentet e tyre themeluese.

4. organizatës nuk i është dhënë një kontratë për shërbimet në fjalë nga autoriteti kontraktues përkatës në përputhje me këto kritere, brenda tre viteve të fundit²⁷. Kjo dispozitë e direktivës duhet të interpretohet drejtë për të mos krijuar përshtypjen se OJQ-të nuk mund të ofrojnë shërbime të kontraktuara në vazhdimësi.

KAPITULLI IV MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË KONTRATAVE

Në këtë kapitull duhet të adresohet mbikëqyrja e zbatimit të kontratave. Përveç procedurave standarde të përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik, në këtë pjesë mund të parashihen edhe mekanizma tjerë të mbikëqyrjes dhe monitorimit të natyrës ex post dhe ex ante. Anketat me pranuesit e shërbimeve, vlerësime të ekspertët e jashtë, pagesa shtesë në bazë të performancës së mirë dhe inspektimet janë metoda për sigurimin e zbatimit të kontratave dhe rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

KAPITULLI V – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Në këtë pjesë përcaktohet hyrja në fuqi e aktit nënligjor.

²⁷ Neni 77. Paragrafi 2 i Direktivës 24/2014

